


PRESHEVA PA STACION AUTOBUSI:

PASOJAT PËR VAJZAT DHE GRATË



Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
1. Qëllimi dhe metodologjia	4
2. Profili i pjesëmarrëseve	4
3. Preshevë–Bujanoc: arsim, punë dhe pjesëmarrje	4
4. Preshevë–Vranjë: shëndetësi, administratë dhe praktikë profesionale	6
5. Shpenzimet dhe mënyrat alternative të transportit	6
6. Pse ndikimi është veçanërisht i rëndësishëm për vajzat dhe gratë	7
7. Zëri i pjesëmarrëseve	7
8. Rekomandime	7
9. Përfundim	8
Burime dhe shënime metodologjike	8

PRESHEVA PA STACION AUTOBUSI: PASOJAT PËR VAJZAT DHE GRATË

Përvojat e vajzave dhe grave në relacionin Preshevë–Bujanoc–Vranjë

Raport i bazuar në një anketë me 10 pjesëmarrëse dhe në përvojën e studentes Donjeta Agushi

Përmbledhje ekzekutive

Stacioni i autobusëve në Preshevë nuk ekziston që nga viti 2012, kur transportuesi “Kavim-Jedinstvo” e shiti atë të një investitor lokal, i cili në vend të tij ndërtoi një kompleks banesor dhe afarist. Edhe pse ekzistojnë nisje të regjistruara drejt Bujanocit dhe Vranjës, sipas inspektorit të trafikut në Administratën Komunale të Preshevës, ato nuk realizohen tashmë prej katër ose pesë vjetësh. Në një tekst të “Bujanovačke”, një nga bashkëbiseduesit thekson se asnjë pushtet lokal që nga ajo kohë nuk është marrë me çështjen e hapjes së stacionit të autobusëve dhe vendosjes së transportit publik.

Ky raport shqyrton se si mungesa e stacionit të autobusëve në Preshevë dhe pamjaftueshmëria e transportit publik ndërmjet Preshevës, Bujanocit dhe Vranjës ndikojnë në qasjen e vajzave, veçanërisht të grave të reja, në arsim, punësim, praktikë profesionale, shërbime shëndetësore, përbushjen e detyrimeve administrative, si dhe në jetën shoqërore e kulturore. Analiza bazohet në një anketë eksploruese me 10 pjesëmarrëse, si dhe në përvojën e Donjeta Agushit, studente në Fakultetin Ekonomik në Bujanoc. Për shkak të mostrës së vogël, rezultatet nuk paraqiten si statistika përfaqësuese për të gjithë popullsinë, por si gjetje indikative mbi pengesat konkrete të lëvizshmërisë.

Rezultatet tregojnë një varësi të madhe nga automjeti privat dhe anëtarët e familjes, vështirësi të konsiderueshme në organizimin e udhëtimeve, kosto financiare dhe kufizime kohore. Për udhëtimet drejt Bujanocit, 60% e të anketuarave thonë se organizimi i transportit është shumë i vështirë, ndërsa 50% deklarojnë se kanë hequr dorë nga një mundësi arsimore ose profesionale për shkak të transportit të papërshtatshëm. Për Vranjën, 70% thonë se, për shkak të transportit, kanë shtyrë ose kanë hequr dorë nga një kontroll mjekësor, trajtim, detyrim administrativ apo obligim tjetër. Madje, 90% thonë se mungesa e transportit publik ndikon ndjeshëm në orarin e ditës gjatë të cilit mund të udhëtojnë.

Gjetjet kryesore

- 80% e pjesëmarrëseve janë 21–24 vjeç dhe 80% janë studente.
- 60% udhëtojnë ose kanë nevojë të udhëtojnë në relacionin Preshevë–Bujanoc disa herë në javë.
- 70% përdorin automjetin e tyre për udhëtime drejt Bujanocit, ndërsa 30% varen nga një anëtar i familjes.
- 60% mendojnë se organizimi i transportit deri në Bujanoc është shumë i vështirë.
- 50% kanë hequr dorë nga një mundësi arsimore ose profesionale në Bujanoc për shkak të transportit të papërshtatshëm.
- Për udhëtimet drejt Vranjës, 70% përdorin automjetin e tyre, 40% thonë se i dërgon një anëtar i familjes, ndërsa 20% përdorin taksì.
- 70% kanë shtyrë ose kanë hequr dorë nga një kontroll mjekësor, trajtim, detyrim administrativ apo obligim tjetër në Vranjë për shkak të transportit.

- 40% thonë se taksia ose transporti privat paraqet një barrë të madhe financiare, ndërsa 10% thonë se nuk mund ta përballojnë.
- Në shkallën 1–5 për ndjenjën e sigurisë gjatë organizimit të transportit alternativ, 70% kanë zgjedhur 1 ose 2, ndërsa askush nuk ka zgjedhur 5.
- 90% thonë se mungesa e transportit publik ndikon ndjeshëm në orarin e ditës gjatë të cilit mund të udhëtojnë.

1. Qëllimi dhe metodologjia

Qëllimi i raportit është të dokumentojë se si mungesa e stacionit të autobusëve dhe e linjave të rregullta, të parashikueshme dhe financiarisht të përballueshme ndikon në mobilitetin ndërkomunal. Pyetësi u realizua online dhe përfshiu 10 pjesëmarrëse, me pyetje të mbyllura, pyetje me zgjedhje të shumëfishta dhe pyetje të hapura.

Në disa pyetje ishte e mundur të zgjidhej më shumë se një përgjigje, prandaj shuma e përqindjeve në ato pyetje mund të jetë më e madhe se 100%. Kufizim metodologjik: mostra prej 10 pjesëmarrësesh është e vogël dhe përfshin kryesisht gra të reja/studente. Prandaj, përqindjet duhen lexuar si përshkrim i këtij grupi dhe jo si vlerësim i përhapjes së problemit në të gjithë Preshevën, Bujanocin apo Vranjen.

2. Profili i pjesëmarrëseve

Treguesi	Rezultati	Interpretimi
Mosha	21–24: 80%; 30–35: 10%; 62 vjeç: 10%	Në mostër dominojnë gratë e reja.
Statusi	Studente 80%; të punësuar 20%; të papunë 10%	Arsimi i lartë është dimension qendror i mobilitetit.
Vendi i banimit	Qyteti Preshevë 30%; fshatrat e komunës Preshevë 30%; qyteti Bujanoc 20%; fshatrat e komunës Bujanoc 20%	Të përfshira janë mjedise urbane dhe rurale.

3. Preshevë–Bujanoc: arsim, punë dhe pjesëmarrje

Nevoja për udhëtim drejt Bujanocit është e shpeshtë: 10% udhëtojnë çdo ditë, 60% disa herë në javë, 20% disa herë në muaj, ndërsa 10% më rrallë. Arsytet përfshijnë fakultetin, punën, praktikën profesionale, nevojat shëndetësore, detyrimet administrative, blerjet dhe aktivitetet kulturore.

Mënyra e udhëtimit tregon se mungesa e alternativës së transportit publik kompensohet me burime private: 70% përdorin automjetin e tyre, 30% thonë se i dërgon një anëtar i familjes, 10% një mik ose i njohur, ndërsa 10% përdorin taksin. Kështu, kostoja dhe përgjegjësia për mobilitetin barten nga sistemi publik tek individit dhe familja.

Problemet me transportin ndikojnë edhe në pjesëmarrjen e përditshme në aktivitete arsimore, profesionale dhe shoqërore. 60% e pjesëmarrësve thonë se, për shkak të mungesës së transportit, kanë hequr dorë nga aktivitete kulturore, sportive, shoqërore ose rinore; 40% janë vonuar në shkollë, fakultet ose punë, ndërsa 20% kanë munguar në mësim ose ligjërata. Nga pjesëmarrëset, 20% thonë se kanë humbur një mundësi për praktikë profesionale ose trajnim, ndërsa 10% kanë humbur një intervistë pune.

Përveç këtyre vështirësive të përditshme, 60% e pjesëmarrësve thonë se organizimi i transportit deri në Bujanoc është shumë i vështirë, ndërsa gjysma e mostrës ka hequr dorë nga ndonjë mundësi arsimore

ose profesionale për shkak të mungesës së transportit të përshtatshëm. Në pyetjen se nga çfarë konkretisht kanë hequr dorë, disa prej tyre janë përgjigjur:

- *“Nga pjesëmarrja në aktivitete.”*
- *“Nga ngjarjet që janë mbajtur në Bujanoc.”*
- *“Gjithmonë jam vonuar në mësim, si dhe në aktivitete kulturore, gjë që më ka penguar të krijoj edhe miq të rinj.”*
- *“Provim në fakultet.”*
- *“Nga një punë.”*

3.1 Përvoja e Donjeta Agushit – ndikimi në arsim

Donjeta Agushi është studente e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc dhe, për të ndjekur studimet, udhëton rregullisht nga Presheva. Ajo udhëton vetë me makinë, sepse mungesa e transportit publik e vështirëson përdorimin e ndonjë alternative tjetër të besueshme.

Udhëtimi i përditshëm sjell shpenzime të vazhdueshme për karburant dhe mirëmbajtjen e automjetit. Për një studente që çdo ditë përshkon rreth 40 kilometra vajtje-ardhje, konsumi mujor vetëm për karburant mund të arrijë afërsisht 50–60 litra, varësisht nga konsumi i automjetit dhe numri i ditëve të udhëtimit. Këtyre u shtohen edhe shpenzimet për mirëmbajtjen e makinës.

Problemi, megjithatë, nuk kufizohet vetëm te shpenzimet. Donjeta thotë se, për shkak të vështirësive me transportin, ka ndodhur të vonohet në ligjërata ose të mungojë në fakultet. Këto vonesa dhe mungesa ndikojnë drejtpërdrejt në ndjekjen e rregullt të mësimit dhe në cilësinë e arsimit: një ligjërata e humbur mund të nënkuptojë edhe humbjen e një pjese të procesit mësimor, konsultimeve apo aktiviteteve të tjera të rëndësishme akademike.

Situata është veçanërisht e vështirë gjatë dimrit. Ditët më të shkurtra, errësira që bie më herët dhe kushtet më të vështira në rrugë e bëjnë vozitjen vetëm më stresuese dhe kërkojnë kujdes shtesë. Kthimi nga Bujanoci në orët e vona, sidomos në kushte të këqija atmosferike, krijon shqetësim shtesë për sigurinë.

Për Donjetën, një linjë e rregullt e transportit publik Preshevë–Bujanoc do të nënkuptonte më pak shpenzime, më shumë siguri dhe një mënyrë më të qëndrueshme për të ndjekur studimet, pa shqetësimin e përditshëm se si do të arrijë në fakultet dhe si do të kthehet në shtëpi. Përvoja e saj tregon se mungesa e transportit publik nuk është vetëm problem i lëvizjes mes dy qyteteve, por mund të ndikojë drejtpërdrejt në vazhdimësinë dhe cilësinë e arsimit, në sigurinë dhe në mundësinë e vajzave për të studiuar në mënyrë të pavarur.

3.2 Shkolla e Lartë e Studimeve Mjekësore “Hipokrat” në Bujanoc

Në Bujanoc ekziston edhe një institucion i arsimit të lartë për studime profesionale në profilet shëndetësore – “Hipokrat”. Për të rinjtë nga Presheva që ndjekin ose planifikojnë të ndjekin studime në profilet shëndetësore, lidhja e rregullt e transportit është veçanërisht e rëndësishme, sepse arsimi profesional, përveç mësimit teorik, përfshin edhe detyrime praktike dhe orare që mund të jenë më pak fleksibël.

4. Preshevë–Vranjë: shëndetësi, administratë dhe praktikë profesionale

Nevoja për udhëtim drejt Vranjës është gjithashtu e konsiderueshme: 20% udhëtojnë çdo ditë, 30% disa herë në javë, 30% disa herë në muaj dhe 20% më rrallë. Arsyet më të shpeshta janë kontrollet shëndetësore dhe blerjet (nga 60%), të ndjekura nga detyrimet administrative dhe trajnimet/praktikat profesionale (nga 30%).

Edhe këtu dominon transporti privat: 70% përdorin automjetin e tyre, 40% thonë se i dërgon një anëtar i familjes, 20% përdorin taksì, ndërsa nga 10% varen nga miqtë/të njohurit ose e ndajnë transportin me të tjerë.

Pasojat më të theksuar lidhet me qasjen në shërbime: 70% thonë se kanë shtyrë ose kanë hequr dorë nga një kontroll mjekësor, trajtim, detyrim administrativ apo obligim tjetër në Vranjë, sepse nuk kanë pasur transport të përshtatshëm; 10% thonë se nuk e kanë bërë këtë, ndërsa 20% thonë se nuk kanë pasur nevojë të tillë.

Në përgjigjet e hapura, pjesëmarrëset përmendin anulimin e trajnimeve dhe mungesën në praktikën profesionale, si dhe vështirësitë për të shkuar në kontrolle shëndetësore dhe për të kryer detyrimet administrative. Një pjesëmarrëse thotë se, për të shkuar në një kontroll, ka qenë e detyruar të paguajë 2.000 dinarë për taksì nga Presheva në Vranjë, ndërsa një tjetër thotë se nuk ka mundur të marrë dokumentin e nevojshëm, sepse nuk kishte makinë dhe as ndonjë mundësi tjetër transporti.

4.1 Praktika profesionale tremujore në Vranjë për infermierë/infermiere

Një çështje të veçantë paraqet praktika profesionale për profilet e infermierisë. Sipas informacioneve të mbledhura për këtë raport, një pjesë e të rinjve nga Presheva duhet të kryejnë praktikë profesionale për rreth tre muaj në Vranjë, ndërsa vështirësitë në transport ndikojnë që shumë prej tyre të mos e vazhdojnë këtë proces. Për publikimin e raportit rekomandohet që kohëzgjatja dhe kushtet formale të praktikës të mbështeten me dokumentacion ose vërtetim nga institucioni kompetent.

Ky problem është i rëndësishëm sepse praktika profesionale përfaqëson lidhjen mes kualifikimit formal dhe hyrjes në profesion. Nëse mungesa e transportit e bën ndjekjen e praktikës financiarisht të papërbalueshme, të vështirë për t'u realizuar në aspektin kohor ose të pasigurt, pengesa në mobilitet shndërrohet edhe në pengesë për punësim dhe zhvillim profesional.

5. Shpenzimet dhe mënyrat alternative të transportit

Përgjigjet e hapura mbi shpenzimet mujore përfshijnë shumën të ndryshme, ndër të cilat 5.000 dinarë, 10.000 dinarë dhe rreth 100 euro në muaj, ndërsa disa pjesëmarrëse nuk kanë mundur të japin një vlerësim të saktë. Për shkak të njësive të ndryshme dhe vlerësimeve të paplota, nuk është e arsyeshme të llogaritet një mesatare e besueshme, por përgjigjet tregojnë qartë se transporti privat paraqet një shpenzim të konsiderueshëm për buxhetin personal ose familjar.

Kur janë pyetur për përballueshmërinë financiare të taksisë ose transportit privat, 20% thonë se mund ta përballojnë pa vështirësi të mëdha, 30% vetëm herë pas here, 40% thonë se paraqet një barrë të madhe financiare, ndërsa 10% thonë se nuk mund ta përballojnë.

Mungesa e transportit publik kërkon edhe gjetjen e mënyrave alternative të transportit. 60% e pjesëmarrëseve thonë se kanë qenë të detyruara të presin gjatë për transport, 30% të ecin në këmbë një pjesë të rrugës, ndërsa 30% kanë qenë të detyruara të largohen më herët nga mësimi, puna ose ndonjë

aktivitet për të siguruar transportin për t'u kthyer në shtëpi. Vetëm 20% thonë se nuk janë gjendur në asnjërën nga këto situata.

6. Pse ndikimi është veçanërisht i rëndësishëm për vajzat dhe gratë

Kur duhet të organizojnë transport alternativ jashtë Preshevës, 70% e pjesëmarrëseve e vlerësojnë ndjenjën e sigurisë me notën 1 ose 2, ndërsa asnjëra nuk e vlerëson me notën më të lartë. Kufizimet shihen edhe në kohën kur mund të udhëtojnë. Nëntë nga dhjetë pjesëmarrëse thonë se mungesa e transportit publik ndikon ndjeshëm në orarin e ditës gjatë të cilit mund të udhëtojnë, ndërsa njëra thotë se ndikon disi. Asnjëra nuk është përgjigjur se mungesa e transportit publik nuk ndikon.

20% e pjesëmarrëseve kanë pranuar transport nga një person me të cilin nuk janë ndier plotësisht të sigurt, ndërsa gjysma ka hequr dorë të paktën një herë nga ndonjë aktivitet, sepse nuk ka pasur një mënyrë të sigurt për t'u kthyer në shtëpi.

Kur transporti publik mungon, organizimi i udhëtimit shndërrohet në çështje improvizimi, pritjeje, ecjeje dhe pranimit të transportit nga persona të panjohur.

7. Zëri i pjesëmarrëseve

Disa nga përgjigjet e dhëna nga pjesëmarrëset në anketë:

“Për shembull, gjatë kthimit nga Gjermania, autobusi nga Kosova ndalet në Bujanoc dhe më duhej të prisja motrën të vinte të më merrte.”

“Shumë herë më ka paraqitur problem.”

“Nuk kam mundur të shkoj në fakultet.”

“Do të udhëtoja pa stres.”

“Do të mund të udhëtoja kur të doja, e jo vetëm sipas mundësive.”

“Do të udhëtoja çdo ditë lirshëm dhe e sigurt, do të zhvilloja profesionalisht veten, do të krijoja marrëdhënie të reja shoqërore dhe do të merrja më shumë pjesë në aktivitete kulturore.”

“Nuk do ta përdorja makinën çdo ditë.”

“Nuk do të kishim aq shumë shpenzime për karburant dhe do të ishim më të sigurt.”

Në pyetjen se sa do t'ua lehtësonte jetën e përditshme vendosja e një linje të rregullt të transportit publik nga Presheva drejt Bujanocit dhe Vranjës, të gjitha dhjetë pjesëmarrëset u përgjigjën se do t'ua lehtësonte jetën. Në përgjigjet e tyre, ato përmendin më pak stres dhe shpenzime, më pak varësi nga automjeti dhe personat e tjerë, udhëtim më të sigurt dhe mundësi më të mëdha për të planifikuar detyrimet.

8. Rekomandime

1. **Të vendoset një linjë e rregullt Preshevë–Bujanoc–Vranjë.** Orari i udhëtimeve duhet të përfshijë nisjet e mëngjesit, kthimet pas mësimit ose punës, si dhe orare të përshtatshme pasdite dhe në mbrëmje.

2. **Të harmonizohet orari me institucionet arsimore dhe shëndetësore.** Planifikimi duhet të bëhet në konsultim me studentët, shkollat dhe fakultetet, institucionet shëndetësore dhe institucionet ku realizohet praktika profesionale.
3. **Të vendosen tarifa të përballueshme dhe bileta mujore për studentët dhe praktikantët.** Subvencionet ose biletat mujore mund të ulin varësinë nga taksitë dhe të zvogëlojnë shpenzimet për përdorimin e automjetit privat.
4. **Të sigurohet një zgjidhje për praktikën profesionale në Vranjë.** Të shqyrtohet mundësia e organizimit të transportit ose e rimbursimit të shpenzimeve të udhëtimit për të rinjtë që kryejnë praktikë të detyrueshme ose profesionale.
5. **Të përfshihen fshatrat në sistemin e transportit.** Linja kryesore duhet të lidhet me pika grumbullimi ose me linja lokale nga vendbanimet rurale.
6. **Të vendoset një standard i sigurisë dhe parashikueshmërisë.** Oraret, stacionet dhe informacionet për udhëtimet duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të besueshme.

9. Përfundim

Të dhënat e këtij hulumtimi të vogël, por të fokusuar, tregojnë se mungesa e transportit publik në relacionin Preshevë–Bujanoc–Vranjë nuk është vetëm çështje komoditeti. Ajo ndikon në mundësitë dhe vendimet arsimore, profesionale, shëndetësore dhe shoqërore, si dhe në sigurinë e vajzave dhe grave. Pjesëmarrëset përmendin vonesa, heqje dorë nga aktivitete dhe mundësi, shtyrje të detyrimeve, shpenzime të larta dhe varësi nga automjeti privat ose anëtarët e familjes.

Prandaj, çështja e transportit duhet të lidhet drejtpërdrejt me politikat lokale në fushën e arsimit, punësimit të të rinjve, shëndetësisë, barazisë gjinore dhe zhvillimit rajonal.

Burime dhe shënime metodologjike

- Anketë online e realizuar për nevojat e këtij hulumtimi, n = 10.
- Intervistë me Donjeta Agushin, studente e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc, e realizuar për nevojat e këtij raporti.
- Të dhënat për praktikën profesionale tremujore për profilet e infermierisë në Vranjë bazohen në informacionet e mbledhura për këtë raport; para publikimit rekomandohet konfirmimi institucional i detajeve.
- Për shkak të mostrës së vogël, gjetjet e anketës nuk janë statistikisht përfaqësuese për të gjitha vajzat dhe gratë në Preshevë, Bujanoc dhe Vranjë.
- *Bujanovačke*, „Preševo, grad odakle je nemoguće otputovati javnim prevozom“, 15 prill 2026.

<https://bujanovacke.co.rs/2026/04/15/presevo-grad-odakle-je-nemoguce-otputovati-javnim-prevozom/>